

URDHËR
Nr. 317, datë 26.3.2026

PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENIN E SHKODRËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë të krapit – (*Cyprinus carpio*) në liqenin e Shkodrës, për periudhën 1.4.2026 deri më 30.4.2026.

2. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë të gjuhçës (cironkës) – *Alburnus Albidus Alborella* në liqenin e Shkodrës, për periudhën 1.4.2026 deri më 30.6.2026.

3. Për periudhën 1.4.2026 deri më 30.4.2026 lejohet të peshkohet vetëm ngjala me grepa nga subjektet e pajisura me leje peshkimi nga Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës, siç është parashikuar në Planin e Menaxhimit të Ngjalës.

4. Për periudhën 1.5.2026 deri më 30.6.2026, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore prej 200 m nga bregu.

5. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë sipas zonave të përcaktuara nga Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës.

6. Për periudhën e lejimit të peshkimit të ngjalës, sipas pikës 3 të këtij urdhri, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës të ketë monitorim të sasive ditore të peshkuara.

7. Peshku i sekuestruar nga peshkimi i paligjshëm groposet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri të hartohet një Plan i Përbashkët Operativ Veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në koordinim me Organizatën e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës.

9. Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës të marrë të gjitha masat e zhvendosjes së objekteve ku peshqit kanë lëshuar vezët, në rastet e rënies së nivelit të ujit në liqenin e Shkodrës.

10. Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës bashkëpunon me strukturat e qeverisjes vendore, Drejtorinë Rajonale të AKU-së Shkodër, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare në qarkun e Shkodrës dhe Policinë Bashkiake të Shkodrës dhe Malësisë së Madhe.

11. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla